

D E K R E T
Nr.1155, datë 18.7.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 “PËR LËSHIMIN E
PASAPORTAVE PËR JASHTË SHETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 2 të dekretit nr.7393, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Pasaporta është individuale dhe me të pajisen shtetasit që kanë mbushur moshën 16 vjeç. Nën këtë moshë pajisen shtetasit që:

a) janë të sëmurë dhe e kanë të domosdoshme daljen jashtë shtetit, e vërtetuar kjo me raport mjeko-ligjor;

b) janë fëmijë të mbajtësve të pasaportave diplomatike;

c) shkojnë jashtë shtetit për aktivitete sportive, kulturore, artistike, shkencore, si dhe për studime.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha